

Termat e Referencës dhe Fushëveprimi i Shërbimeve

Specialist për Komunikim dhe Çështje Sociale

(Numri ref. i kontratës XK- REGIP- 404824-CS-INDV)

Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë një kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 16.00 milion dollarë amerikan për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore, që pritet të zbatohet brenda pesë viteve. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të rrisë transparencën dhe cilësinë e administrimit të tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin Analiza REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP). NjIP do të ketë Koordinatorin e NjIP-it, Specialistin e Prokurimit, Specialistin e Menaxhimit Financiar, Specialistin për Komunikim dhe Çështje Sociale dhe staf tjetër teknik si Specialistë për GIS/Kadastër. NjIP është përgjegjëse për zbatimin e përditshëm të projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve të projektit. NjIP gjithashtu është përgjegjëse për të gjitha aspektet e besueshmërisë, siç janë prokurimi, menaxhimi financiar, monitorimi dhe vlerësimi, dhe masat mbrojtëse sipas Projektit.

I. Hyrje

Ky dokument përshkruan përgjegjësitë, fushëveprimin e punës dhe kualifikimet për pozitën e Specialistit për Komunikim dhe Çështje Sociale në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK).

II. Objektivi

Specialisti për Komunikim dhe Çështje Sociale do të zhvillojë dhe zbatojë strategji të komunikimit që:

- Përafrojnë komunikimet me politikat dhe iniciativat korporative të AKK-së.
- Përafrojnë aktivitetet e komunikimit dhe menaxhimit të rrezikut social me Politikat Operacionale Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (përfshirë OP 4.01. për Vlerësimin Mjedisor)
- Promovojnë misionin, projektet, produktet dhe aktivitetet e AKK-së.
- Sigurojnë përfshirjen sociale të grupeve të cënueshme në shfrytëzimin e të drejtave pronësore.
- Mbajnë marrëdhënie të qëndrueshme me palët e interesit.

III: Fushëveprimi i punës

1. Komunikimet strategjike

- Kryen vlerësimet e nevojave për komunikim për projektet, programet dhe iniciativat për ndryshime korporative.

- Zhvillon strategjitë për marrëdhënie me publikun (komunikimi, ndërgjegjësimi, mediat dhe mediat digjitale) të harmonizuara me misionin, projektet, produktet dhe aktivitetet e AKK-së, duke marrë parasysh objektivat, politikat dhe nevojat e palëve të interesit.
- Integron komunikimet, avokimin dhe planet e ndërgjegjësimit në propozimet për projekte, programe dhe iniciativa të tjera.
- Mbështet AKK-në në aktivitetet e ndërlidhura me komunikimin e projektit (p.sh. përgatitja e TeR-ve dhe pjesëmarrja në komisionet vlerësuese).

2. Menaxhimi i fushatës

- Drejton angazhimin, menaxhon dhe koordinon mbështetjen e jashtme (agjencia për marrëdhënie me publikun dhe specialistët)
- Drejton zbatimin e planit të Fushatës së Ndërgjegjësimit Publik (FNP) të REGIP-it, duke përfshirë rishikimet periodike.
- Mbikëqyrë zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të informacionit publik përmes kanaleve efektive.
- Identifikon mundësitë, aktivitetet, platformat dhe partneritetet promovuese.
- Udhëheq konceptimin dhe organizimin e ngjarjeve (për të promovuar punën dhe aktivitetet e AKK-së).
- Menaxhon faqen e internetit të AKK-së dhe llogaritë e mediave sociale

3. Marrëdhëniet me mediat

- Krijon dhe mban marrëdhënie afatgjata dhe të qëndrueshme me mediat.
- Zbaton aktivitetet e marrëdhënieve me mediat (prodhimi i paketave mediatike, kumtesat për shtyp, organizimi i sesioneve informuese, konferencave, intervistave, vendosja e artikujve dhe paraqitjet e të ftuarve) për të promovuar aktivitetet e AKK-së.
- Identifikon storje të vlefshme për lajme (studime rastesh, histori suksesi, rezultate të anketave) dhe shfrytëzon marrëdhëniet me mediat për të maksimizuar mbulimin.
- Ju përgjigjet menjëherë dhe me saktësi pyetjeve të mediave.

4. Angazhimi i palëve të interesit

- Krijon listën e palëve të interesit dhe zhvillon një plan vjetor të angazhimit.
- Identifikon grupet e cënueshme
- Organizon punëtori, trajnime, takime dhe seminare për grupe të ndryshme të palëve të interesit (për të informuar, rritur ndërgjegjësimin, trajnuar dhe për të fituar mbështetje).
- Përshtat aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit për grupet e cënueshme të identifikuara dhe sigurohet që pjesëmarrja e tyre në aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit të jetë kuptimplotë.
- Identifikon palët kryesore të interesit, vendimmarrësit dhe zhvillon një plan vjetor të angazhimit (për të promovuar rezultatet e projektit, për të fituar mbështetje dhe për të rritur pjesëmarrjen).

5. Monitorimi dhe vlerësimi

- Përcakton treguesit e performancës së komunikimit.
- Mat performancën e komunikimit duke përdorur matjet dhe analitikën e drejtuar nga të dhënat.

- Monitoron, vlerëson dhe raporton për performancën e komunikimit çdo muaj, si dhe propozon përmirësime (për të arritur objektivat e komunikimit).

6. Politikat e mbrojtjes sociale

- Menaxhon mekanizmin e zgjidhjes së ankesave të projektit për adresimin e pakënaqësive, ankesave, shqetësimeve dhe komunikimeve të tjera që lidhen me të gjitha aktivitetet e projektit, sipas Politikave Operacionale të Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore.
- Promovon përfshirjen sociale duke siguruar përfshirjen, qasjen në informacion dhe pjesëmarrjen kuptimplotë të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara.
- Angazhohet për të shmangur dhe zbutur rreziqet dhe ndikimet negative në grupet e cënueshme dhe të marginalizuara
- Angazhohet për t'ua mundësuar grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara që të kenë qasje të barabartë në përfitimet e projektit

7. Mbështetja specifike e komponentit të përgjithshëm

- Promovon planin dhe projektimin të aktiviteteve të Rindërtimit të Informacionit Kadastral (RIK).
- Mbështet përpjekjet për përfshirjen gjinore në kuadër të RIK, duke përfshirë komisionin e RIK.

8. Bashkëpunimi

- Bashkëpunon ngushtë me stafin e projektit për strategjitë e komunikimit dhe implementimit.
- Koordinon aktivitetet me Zyrrat Kadastrale Komunale (ZKK).
- Mban komunikim dhe koordinim efektiv me donatorët.
- Bashkëpunon me partnerët e shoqërisë civile në aktivitetet e fushatës e ndërgjegjësimit publik.
- Koordinon dhe mbikëqyr profesionistët e mbështetjes së komunikimit të jashtëm (agjencia për marrëdhënie me publikun bashkëpunëtorët) (për të siguruar implementimin e suksesshëm të aktiviteteve të fushatës).

IV. Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë universitare ose Master në komunikim, shkencë sociale ose një fushë ekuivalente.
- Së paku katër (4) vite përvojë në marrëdhënie me publikun, komunikim, ndërgjegjësim ose përfshirje sociale.
- Njohuritë në sektorin e pronës në Kosovë janë përparësi.
- Përvoja e punës me Bankën Botërore ose organizata të tjera ndërkombëtare në zbatimin e mbrojtjeve sociale është përparësi.
- Përvojë të dëshmuar në zbatimin e fushatave të informimit publik dhe strategjive të ndryshme të angazhimit të palëve të interesit, përfshirë punën me shoqërinë civile dhe grupet avokuese.
- Kuptim të gjerë të çështjeve zhvillimore në Kosovë, kontekstit socio-politik, ekonomik dhe kulturor.
- Aftësi të dëshmuar për të menaxhuar marrëdhëniet me mediat dhe për të siguruar mbulim të favorshëm mediatik.
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar, të folur, prezantim dhe ndërveprim ndërpersonal, si dhe aftësi për të punuar në mënyrë bashkëpunuese në një mjedis me shumë palë të interesit.

- Aftësi për zhvillim të shpejtë në një mjedis dinamik dhe të drejtuar nga afatet, për të përmbushur afatet dhe për të menaxhuar të tjerët në arritjen e afatet.
- Kërkohet njohja e rrjedhshme e gjuhës angleze dhe shqipe në të shkruar dhe të folur. Njohja e gjuhës serbe është përparësi.

V. Periudha e performancës

Specialisti për Komunikim dhe Çështje Sociale pritet të fillojë punën në Gusht 2024 me orar të plotë (8 orë), dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të jetë deri në fund të projektit REGIP (31 gusht 2025), me mundësi vazhdimi në bazë të datës së mbylljes së projektit Pagesa do të kryhet në bazë të tarifës mujore të rënë dakord në kontratë. Specialist pritet të fillojë shërbimet me nënshkrimin e kontratës.

VI. Raportimi

Specialisti për Komunikim dhe Çështje Sociale do t'i raportojë Koordinatorit të NjIP-it dhe do të dorëzojë raportin e vijueshmërisë në punë për të llogaritur ditët aktuale të punës gjatë muajit kalendarik.

VII. Procesi i përzgjedhjes

Bazuar në thirrjen e hapur, individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), të nxjerra në korrik të vitit 2016 dhe të rishikuara në nëntor të viti 2017 dhe gusht të vitit 2018, bazuar në thirrjen e hapur për përzgjedhje të Konsulentëve Individual.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit dhe merr vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta punësimi dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale dhe pa diskriminim në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose ndonjë kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.